



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1328/3 prot.

Tiranë, më 26. 12. 2023

V E N D I M

Nr. 256, datë 26. 12. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 257, datë 06.12.2023, të P. M., ku pretendohet diskriminim, *për shkak të aftësisë së kufizuar*, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi P. M., ka qenë i punësuar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Mine Peza”, Tiranë, nga viti 2000 deri në vitin 2007, me detyrë punonjësi i rolit bazë në sektorin e Ruajtjes së Sigurisë. Më datë 30.07.2007 për arsye shëndetësore është shkëputur nga puna dhe është trajtuar me invaliditet të plotë deri në datë 01.10.2016. Ankuesi sqaron se më datë 22.12.2016, KMCAP Epror e ka trajtuar me invaliditet të pjesshëm, duke rekomanduar mundësinë e punësimit për 6 orë (punë të lehtë).

Në këto kushte, fillimisht në vitin 2017, ankuesi i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me kërkesë për rikthimin e tij, për të ushtruar funksionin pranë sistemit të burgjeve, në detyrën e punonjësit të rolit bazë në sektorin e Ruajtjes së Sigurisë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Nga ana e institucioneve të sipërcituara, ankuesi thekson se ka marrë përgjigje se kërkesa e tij do të mbahet në vëmendje, por nuk i është ofruar asnjë pozicion pune. Në vijim, në vitin 2019, përmes shkresës nr. 2720/MD-1 prot., datë 24.10.2019, ankuesi i është drejtuar sërish Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me kërkesë për punësimin e tij në sistemin e burgjeve, por është informuar se referuar dinamikave dhe përshkrimit të detyrave të pozicionit të punës së Punonjësit të Policisë së Rolit Bazë, nuk është i mundur punësimi i tij.

Për sa më lart, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi nuk kanë marrë në konsideratë kërkesat e vazhdueshme për punësimin e tij në sistemin e burgjeve. Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “*1. Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës,*

trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, rezulton se data e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është data 24.10.2019, kur ankuesit i është kthyer përgjigje së fundmi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresën nr. 2720/MD-1 prot., fakt i cili është pohuar dhe nga vetë ankuesi gjatë parashtrimit të fakteve. Ndërkohë që, data e marrjes dijani sipas ankuesit mbi diskriminimit të pretenduar është data 23.11.2023, datë të cilën ai e citon se është informuar nga ana e një avokat për sjelljen diskriminuese. Pra, ankuesi e lidh momentin e marrjes dijani mbi sjelljen diskriminuese, kur ai gjatë konsultimit me një avokat ka kuptuar se ndaj tij është kryer një sjellje diskriminuese.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është data **24.10.2019**, kur me shkresën nr. 2720/MD-1 prot., datë 24.10.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ankuesi është informuar për faktin se punësimi i tij nuk është i mundur. Pavarësisht nga sa pretendohet prej tij, edhe momenti i marrjes dijani nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është data **24.10.2019**. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është **06.12.2023**. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 257, datë 06.12.2023 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë se janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr. 257, datë 06.12.2023, e P. M., pasi është jashtë afateve ligjore për t'u shqyrtuar nga ky institucion.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja dh), nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 257, datë 06.12.2023, së P. M., pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Punësim)